



| | | | |
|---|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prudato Received/Delivered | 29.08 | 3 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKINSHUK | 5809/2023 | | 117 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1009/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arditë Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1009/2023, të datës 19.07.2023 të ankueses me adresë banimi: , kundër Vendimit KA.nr.20/2023 të datës 23.06.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.20/2023 i datës 23.06.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- II. Anulohet Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare me Nr:03/701 e datës 12.05.2023, Lista e ngushtë e kandidatëve duke përfshirë rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni i Pranimit i datës 10.05.2023, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje*.
- III. Obligohet Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të *ri-zhvilloj* procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media" në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.
- IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja [REDACTED], e cila sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit "Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media" në Gjykatën Themelore të Mitrovicës të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 19.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar dhe protokolluar me numër 5300/2023, kundër Njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare me numër 03/701 të datës 12.05.2023.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesja është përfshirë në fazat e procedurës konkretisht listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e cekur më lartë sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve, ankuesja është renditur e treta me pikë me gjithsej 369.75, ndërsa sipas Njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023, ankuesja nuk rezulton të jetë kandidatë e suksesshme.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Pranimit ka zbatuar gabimisht dispozitat e aplikuara ligjore me rastin e vlerësimit të biografisë së kandidatit fitues pasi që e njëjta përvojën e punës nuk e ka në fushën në të cilën zhvillohet procedura, me kërkesën që konkursi i kontestuar të anulohet për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 24.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Ndërsa me datë 27.07.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; CV e ankueses [REDACTED]; Kopja e letërnjoftimit të [REDACTED]; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër K-134/93-09/5 E DATËS 27.03.2003; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KA.nr.20/2023 i datës 23.06.2023; Pasqyra e llogarisë në Trust për ankuesen [REDACTED] për periudhën kohore 01.08.2002 deri 29.06.2023; Kontratë pune e lëshuar nga Kompania Regjionale e Mbeturinae "Uniteti" SH.A me numër 27 e datës 14.11.2019; Marrëveshje për shërbime të veçanta e lëshuar nga Komuna e Mitrovicës me numër 01-1/2.322/8 e datës 23.03.2015; Marrëveshje e lëshuar nga Caritas Kosova e datës 27.03.2013; Marrëveshje e lëshuar nga Community Bulding Mitrovica e datës 28.02.2011; Kontratë për Shërbime e lëshuar nga Menagment Development Associates e datës 10.10.2012; Marrëveshje për shërbime të veçanta e lëshuar nga OJQ "Me dorë në zemër" e datës 01.06.2011; Marrëveshje për shërbime e lëshuar nga Lëvizja FOL; Kontratë e lëshuar nga Community Bulding Mitrovica e datës 01.07.2009; Marrëveshje e lëshuar nga Community Bulding Mitrovica e datës 10.05.2010; Marrëveshje e lëshuar nga Mitrovica Women Asociaation for Human Rights e datës 22.04.2014;Përshkrim i vendit të punës të lëshuar nga Community Bulding Mitrovica e datës 01.10.2007; Marrëveshje e lëshuar nga M-M@gazine e datës 30.12.2011; Certifikatë mbi dënimet penale e lëshuar për [REDACTED] e datës 28.02.2023; Certifikatë e lëshuar nga Building Resources in Democacy e datës 12.12.2014; Certifikatë e lëshuar nga Deutsche Ëelle e datës 26.09.2008; Certifikatë e lëshuar nga DË-Akademie e datës 18.12.2009;Vërtetim i lëshuar nga Inciativa Qytetare për të drejtat e njeriut-Mitrovicë e datës 25.10.2017; Certifikatë e lëshuar nga

USAID Kosova, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve të Brendshme e datës 08.06.2010; Certifikatë e lëshuar nga Menagmnt Development Associates e datës 04.10.2012; Letër reference e lëshuar nga Organizata e Prindërve të Fëmijëve me numër 01/12 e datës 31.2.2021; Vlerësim i punës për [redacted] e lëshuar nga Udhëheqësi i Zyrës për Informim në Komunën e Mitrovicës e datës 31.08.2015; Pliko me numër R 567621; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 24.07.2023; Përgjigja në ankesë e datës 27.07.2023; Ankesa me numër 01/872 e datës 0.06.2023; Vlerësimet e anëtarëve të Komisionit për [redacted] prej 1-5 faqe; Udhëzues për testin me shkrim për [redacted] e datës 04.05.2023; Testi me shkrim i [redacted], Kërkesa për punësim për [redacted] e datës 03.03.2023; Rekomandim i lëshuar nga Community Bulding Mitrovica e datës 14.08.2012; Vërtetim i lëshuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare e datës 06.02.2013; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare me numër 03/701 e datës 12.05.2023; Propozimi për emërimin e kandidatit të rekomanduar e datës 12.05.2023; Vendim me numër 03/449 i datës 24.03.2023; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues i datës 10.05.2023; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Deklaratat për mosekzistim të konfliktit të interesave të anëtarëve të komisionit e datës 06.04.2023; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 22.02.2023; Konkursi i jashtëm me numër 01/2023 i datës 15.02.2023; Vlerësimet e anëtarëve të komisionit për [redacted] prej 1-5 faqe; Testi me shkrim i [redacted] Udhëzues për testin me shkrim për [redacted] e datës 04.05.2023; Kërkesa për punësim e [redacted] e datës 24.02.2023; Kopja e letërnjoftimit të [redacted] Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPoHE Kolegji AAB për [redacted] me numër 579/2022 e datës 28.04.2022; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPoHE Kolegji AAB për [redacted] me numër 541/10 e datës 13.09.2010; Kontratë pune për kohë të caktuar e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor me numër 03/1793 e datës 22.09.2022; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 01.01.2022; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 31.12.2021; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 14.06.2021; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 22.12.2020; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 30.06.2020; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 26.12.2019; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 26.06.2019; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 31.12.2018; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër 074/11 e datës 07.07.2011; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër 1288/2012 e datës 18.12.2012; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 3068/2014 e datës 30.01.2014; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 3589/2014 e datës 15.09.2014; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 1922/2015 e datës 10.12.2015; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 2342/2018 e datës 11.10.2018; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 2699/2017 e datës 22.11.2017; Vërtetim i lëshuar nga Av. Zef Berisha e datës 21.08.2010; Certifikatë e lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë 04 Nr.221 e datës 14.08.2009; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Trajnimeve dhe Karrierës i datës 23.12.2013; Pliko me numër 03/1080 e datës 27.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 15.02.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për pozitën me numër 01/2023: "Udhëheqës i Zyrës

për Informim dhe Komunikim me Media" në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ndërsa bazuar në Renditjen Përfundimtare të kandidatëve konstatohet fakti se ankuesja ka arritur ti mbledh 369.75 pikë duke u renditur e treta në listë, rrjedhimisht nuk është përzgjedhur si kandidate fituese.

Ankuesja, e pakënaqur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, kishte parashtruar ankesë të brendshme me pretendimin ankimor se kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojën adekuate në fushën e mediave, ndërsa Komisioni për Zgjedhjen e kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit me numër KA.nr.20/2023 të datës 23.06.2023 kishte refuzuar ankesën e ankueses me arsyetimin se në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja fituese i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara me konkurs. Në këtë mënyrë Menaxheri i Personelit ka nxjerr Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën e shpallur të konkursit nga rezulton se ankuesja nuk ishte kandidate e përzgjedhur.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin e shpallur të datës 15.02.2023, për pozitën "Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media" në Gjykatën Themelore të Mitrovicës me numër 01/2023, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë Universitare të vlefshme në Kosovë: e preferuar Fakulteti i Gazetarisë ose ndonjë fushë e përafërt.*
- *Përvoja e punës: Se paku pesë (5) vite përvoja pune.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me kërkesën e saj për anulimin e konkursit për shkak se kandidati fitues nuk e ka përmbushur kriterin e konkursit lidhur me përvojën e punës në fushën në të cilën zhvillohet procedura, Kolegji i Këshillit pas analizimit të aplikacionit dhe dokumentacioneve të bashkangjitura të dorëzuar nga kandidatja fituese ka konstatuar se kandidatja fituese posedon Diplomën e datës 28.04.2022 me numër:579/22 përmes të cilët dëshmohet fakti se e njëjta ka Diplomuar në Programin Juridik i Përgjithshëm në Kolegjin AAB dhe ka marr gradën LLB në Juridik, po ashtu e njëjta posedon Diplomën e datës 13.09.2010 me numër:541/10 përmes të cilët dëshmohet fakti se e njëjta ka mbaruar studimet themelore universitare në Fakultetin Juridik në Kolegjin AAB dhe ka marr titullin Baçelor për Administratë Publike dhe Diplomaci, fushë kjo e është cila është e përafërt e studimeve me fakultetin e gazetarisë ashtu që e njëjta ka përmbushur kriterin sa i përket arsimimit të kërkuar, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses lidhur me kualifikimin e kandidates së suksesshme është i papabuar.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar faktin se kandidatja e përzgjedhur përvojën e punës së fituar në institucione private nuk e ka dëshmuar me dokumentacionin e nevojshëm respektivisht në kërkesën për punësim të datës 24.02.2023 nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument përcjellës nga Trusti i Kursimeve Pensionale apo nga Administrata Tatimore Kosovës, sepse përvoja e punës në sektorin privat e provuar vetëm përmes shkresave të lëshuar nga punëdhënësi nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet përgjegjëse, kështu që lidhur me këtë Kolegji i Këshillit, ju ka referuar Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, e cila ka theksuar se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmojnë me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës apo dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar edhe me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës, respektivisht nga dosja e ankueses të dërguar në Sekretariatit e Këshillit Gjqësore të Kosovës, sikurse edhe në provat e bashkangjitura me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, si dokument të mbarimit të studimeve ka ofruar Çertifikatën e datës 27.03.2003 lëshuar nga Shefi i Shërbimit të Studentëve në Fakultetin Juridik sipas së cilës shkresë specifikohet se ankuesja i ka mbaruar studimet pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me datë 31.05.2002, mirëpo Kolegji i Këshill vlerëson se certifikatat e tilla janë të karakterit të përkohshëm deri në përgatitjen e Diplomës, kurse në rrethanat e rastit konkret certifikata e lartcekur është lëshuar prej më shumë se njëzet (20) vitesh, ndërsa ankuesja në aplikacionin e saj nuk ka bashkangjitur Diplomë pavarësisht faktit se në jetëshkrimin (CV-në) e saj deklaron se posedon Diplomë, andaj në një situatë të tillë, Komisioni Përzgjedhës i SKGJK-së është dashur ta trajtojë këtë çështje, madje nëse ka qenë e nevojshme t'i kërkoje palës të sjell Diplomën e deklaruar apo t'i drejtohet Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me qëllim të verifikimit të faktit nëse ankuesja posedon diplomë, pasi që edhe sipas Statutit aktual të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në nenin 135 paragrafi 1 ka përcaktuar se: "1. Përfundimi i suksesshëm i studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes **diplomës** që është dokument zyrtar", madje konkursin e shpallur të datës 15.02.2023 është kërkuar diplomë si dëshmi e kryerjes studimeve të arsimit të lart universitar apo kualifikimit profesional, rrjedhimisht Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës së ankueses përmes Vendimit numër KA.nr.20/2023 të datës 23.06.2023 nuk ka arritur të arsyetojë mjaftueshëm aktin e nxjerrë nëse të gjithë kandidatët në këtë procedurë të rekrutimit i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit të datës 15.02.2023, ndërsa theksojmë faktin se duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative arsyetimi i vendimit është detyrim ligjor, respektivisht arsyetimi jo plotë apo i mangët është i barabartë me mungesën e tij, gjegjësisht kjo çështje rregullohet me nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të të njëjtit ligj.

Bazuar në konstatimet e dhëna si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton faktin se me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përmes të cilës kandidatja e përzgjedhur është përfshirë në listën e ngushtë pavarësisht se përvojën e punës të deklaruar në sektorin privat nuk e ka mbështetur edhe me vërtetim adekuat nga Administrata Tatimore apo Trusti i Kursimeve Pensionale sikurse edhe ankuesja është përfshirë në listën e shkurtë mbi bazën e Çertifikatës së datës 27.03.2003 pa e verifikuar vërtetësinë e saj, Komisioni Përzgjedhës nuk ka arritur të dëshmojë në mënyrë të drejtë nëse të njëjtat i kanë plotësuar kushtet e konkursit gjegjësisht atë të përvojës së punës dhe kualifikimit profesional, ashtu që i njëjti komision ka vepruar në kundërshtim me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës".

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Përzgjedhës në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjqësor të Kosovës, me rastin e përgatitjes së listës së shkurtër përmes të cilës kandidatja e përzgjedhur dhe ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë, nuk ka arritur të dëshmojë apo arsyetojë në mënyrë plotë dhe të drejtë nëse të gjithë kandidatët në procedurë i plotësojnë kushtet e konkursit gjegjësisht kualifikimin profesional atë të përvojës së punës, ashtu që i njëjti komision ka vepruar në kundërshtim me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës", prandaj secili veprim i ndërmarrë procedural pas kësaj faze nga Komisioni

Përzgjedhës duke përfshirë përpilimin e listës së ngushtë, rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë e deri te rekomandim i Komisionit Përzgjedhës për kandidaten e suksesshëm janë të pavlefshme juridikisht dhe nuk mund të prodhojnë efekte juridike pasi që deri të ky rezultat ka ardhë si pasojë e një procedure të përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit material dhe LPPA-së.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve ankimore të ankueses për shkelje të parimeve të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe duke marr parasysh dispozitat të aplikuara ligjore në fuqi duke përfshirë konstatimet e shkeljeve të paraqitura si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura e rekrutimit sipas konkursit me 01/2023 për pozitën *“Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media”* në Gjykatën Themelore të Mitrovicës të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë deri në fazën e përfundimit për arsyet e dhëna si më lartë është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nisur nga konstatimet e dhëna si më lartë ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.20/2023 i datës 23.06.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, respektivisht sikurse përcaktohet në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 11.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”* i njëjtë është vendim i paligjshëm, prandaj është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale të cekura si më lartë në këtë procedurë dhe me qëllim të eliminimit të tyre ka vendosur që të lëndën ta kthej në rishqyrtim, ndërsa Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës obligohet të ndër marr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të *ri-zhvilloj* procedurën e rekrutimit për pozitën *“Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media”* në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë dhe të bëjë rivlerësimin e të gjitha aplikacioneve të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit, duke u bazuar në konstatimet dhe pikëpamjet e dhëna juridike si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, gjithherë në respektim të normave të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1009/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.